

FINANCA

Buletini Maja | JANAR 2026



FORMALIZIMI I NDËRTIMIT – KONFERENCË PËR SHTYP E MINISTRI TË FINANCAVE DHE DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË TATIMEVE

Ministri i Financave dhe Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve zhvilluan një konferencë për shtyp mbi rezultatet e deritanishme të Planit Sektorial për Formalizimin e Ndërtimit, në kuadër të zbatimit të Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave 2024–2027. Ministri Malaj theksoi se lufta kundër informalitetit mbetet një prioritet kyç i qeverisë, me synim

garantimin e konkurrencës së ndershme, mbrojtjen e konsumatorëve dhe forcimin e skemës së sigurimeve shoqërore, pa ndryshuar normat tatimore. Objektivat e Administratës Tatimore përmes planit sektorial të ndërtimit, tha z. Malaj, orientohen kryesisht te formalizimi i tregut të punës, deklarimi real i pagave, por edhe te rritja e deklarimeve dhe qarkullimit të xhiros së bizneseve që operojnë në këtë sektor. “Në themel të punës sonë nuk është ndëshkimi i bizneseve, por është ndërgjegjësimi i tyre në mënyrë që të përmbushin në mënyrë vullnetare detyrimet tatimore”, u shpreh z. Malaj.

► LEXO MË SHUMË

MIRATOHET KUADRI MAKROEKONOMIK DHE FISKAL PËR PERIUdhËN 2027–2029

Këshilli i Ministrave ka miratuar “Kuari Makroekonomik dhe Fiskal për periudhën 2027–2029”, i cili përcakton përparësitë strategjike të qeverisë dhe shërben si dokumenti themelor orientues për projektbuxhetet e viteve të ardhshme. Dokumenti paraqet pritshmëritë makroekonomike në horizontin afatmesëm, si dhe trajton nivelin e të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit të shtetit për periudhën

2027–2029. Kuadri përcakton objektivat kryesore të politikës fiskale, përfshirë deficitin buxhetor, huamarrjen, borxhin publik dhe balancat fiskale. Konsolidimi fiskal mbetet prioritet bazë për të garantuar stabilitetin makroekonomik dhe një rritje ekonomike të qëndrueshme. Deficiti i përgjithshëm fiskal synohet të ulet në 1.6% të PBB në 2027, 1.3% në 2028 dhe 0.9% në 2029, ndërsa balanca primare parashikohet të jetë pozitive gjatë gjithë periudhës, duke arritur në 1.4% të PBB në vitin 2029.

► LEXO MË SHUMË

Miratohet
Kuadri Makroekonomik
dhe Fiskal për periudhën
2027–2029



KUVENDI MIRATON AKTIN NORMATIV NR. 11 PËR BUXHETIN E VITIT 2025

Kuvendi i Shqipërisë miratoi Aktin Normativ nr. 11 për Buxhetin e vitit 2025, i cili fillimisht u paraqit para deputetëve nga Ministri i Financave, Petrit Malaj. Në fjalën e tij, Ministri Malaj theksoi faktin se përmes Aktit Normativ u adresua në mënyrë të menjëhershme nevoja e mbështetjes së shtresave më në nevojë të shoqërisë dhe u garantuan fondet e nevojshme për të mbështetur skemën e pensioneve. “Ky Akt Normativ nuk është thjesht një instrument teknik i menaxhimit buxhetor, por një akt përgjegjshmërie politike dhe qeverisje për ta menaxhuar buxhetin jo vetëm me përgjegjësi, por edhe me ndjeshmëri sociale”, u shpreh z. Malaj. Akti Normativ, tha Ministri, ruan ekuilibrat fiskalë dhe garanton, jo vetëm një mbyllje më optimale të vitit buxhetor 2025, por edhe vijimësinë e konsolidimit fiskal, qëndrueshmërinë afatmesme të financave publike, si dhe stabilitetin makroekonomik të vendit.

► LEXO MË SHUMË

MINISTRI I FINANCAVE MERR PJESË NË DËGJESËN ME FERMERËT NË DIVJAKË PËR SKEMËN KOMBËTARE 2026



Ministri Petrit Malaj mori pjesë në dëgjesën me fermerët në Divjakë, për Skemën Kombëtare 2026, ku shprehu angazhimin e qeverisë për mbështetjen e sektorit të bujqësisë, si një sektor prioritar jo vetëm për numrin e të punësuarve, por edhe për kontributin në ekonomi.

Ministri theksoi faktin se mbështetja financiare për sektorin e bujqësisë është rritur ndër vite, nga 34 milionë euro në vitin 2013, në

► LEXO MË SHUMË



VIZITË NË KOMPANI PËRFITUESE TË STATUSIT OPERATOR EKONOMIK I AUTORIZUAR

Ministri i Financave dhe drejtori i Përgjithshëm të Doganave zhvilluan një vizitë pune në dy kompani shqiptare, të cilat kanë përfituar statusin e Operatorit Ekonomik të Autorizuar. kompaninë “Everest” dhe “Albaelettrica”. Gjatë vizitës, Ministri Malaj u njoh nga afër me aktivitetin e kompanive dhe me përfitimet që ka sjellë statusi i Operatorit Ekonomik të Autorizuar për to. Ministri i Financave

vlerësoi lehtësitë që sjell statusi i Operatorit Ekonomik të Autorizuar, si më pak kontrolle dokumentare dhe fizike, zhdoganim lokal në ambientet e subjektit, kursim të kohës dhe kostove, si dhe i bëri thirrje të gjithë bizneseve që të aplikojnë për të përfituar këtë status. Gjatë vizitës, Ministri Malaj përfitoi nga rasti për të informuar se aktualisht Shqipëria po punon intensivisht për përafrimin e Kodit Doganor me legjislacionin e Bashkimit Europian, proces që pritet të përfundojë brenda këtij viti.

► LEXO MË SHUMË



ZHVILLOHET ANKANDI I INSTRUMENTIT OBLIGACIONE 20-VJEÇARE

Ministria e Financave zhvilloi në 6 janar 2026 ankandin e parë për instrumentin obligacione 20-vjeçare. Shuma e shpallur nga Ministria ishte 1.5 miliardë lekë, ndërkohë vlera totale e kërkesave nga tregu në këtë ankand arriti në 2.91 miliardë lekë. Raporti i mbulimit për këtë ankand është 1.94 herë, i cili tregon kërkesë të lartë nga tregu. Në këtë ankand pjesëmarrja ishte nga të gjithë kategoritë e investitorëve: sistemi bankar, individë, fonde pensioni, fonde investimi. Norma e interesit për këtë instrument ishte 6.72%, ndërkohë emetimi i parë i këtij instrumenti u zhvillua në muajin janar të vitit 2025. Ministria e Financave fton të gjithë të interesuarit të investojnë në titujt qeveritarë në tregun e brendshëm.

► LEXO MË SHUMË



MINISTRI MALAJ NË MBLEDHJEN E KOMITETIT NDËRMINISTOR TË EMERGJENCAVE CIVILE

Qeveria shqiptare ka në dispozicion mbi 50 milionë euro për të përballuar situatën e krijuar në vend si pasojë e motit të keq. Kjo gjë u bë e ditur nga Ministri i Financave gjatë mbledhjes së Komitetit Ndërmintor të Emergjencave Civile, e cila u zhvillua nën drejtimin e Kryeministrit. “Në total, nëse do të bënim një vlerësim të fondeve që kemi në dispozicion, vlera shkon mbi 50 milionë euro që janë të disponueshme për situatën e krijuar aktualisht”, u shpreh z. Malaj. Ministri informoi se këto fonde janë të ndara në disa zëra buxhetorë të dedikuar si për menaxhimin e emergjencave, ashtu edhe për parandalimin e fatkeqësive natyrore.

► LEXO MË SHUMË



KOMITETI I PËRBASHKËT EKZEKUTIV PËR KUADRIN E BASHKËPUNIMIT MES SHQIPËRISË DHE KOMBEVE TË BASHKUARA

Ministri i Financave mori pjesë në mbledhjen e Komitetit të Përbashkët Ekzekutiv për kuadrin e bashkëpunimit mes Qeverisë së Shqipërisë dhe Kombeve të Bashkuara, ku u vlerësua përmbushja e kornizës së bashkëpunimit 2022–2026 dhe rezultatet e arritura deri më tani. Gjatë fjalës së tij, Ministri Malaj vlerësoi bashkëpunimin e frytshëm dhe mbështetjen e vazhdueshme të Kombeve të Bashkuara për

MINISTRI MALAJ, TAKIM ME DREJTUES TË ADMINISTRATËS TATIMORE DHE DOGANORE

Ministri Petrit Malaj zhvilloi një takim pune me drejtuesit e Administratës Tatimore dhe Doganore, ku u diskutuan prioritetet kryesore të punës dhe objektivat strategjike për periudhën në vijim, në funksion të forcimit të

administrimit tatimor dhe doganor. Gjatë mbledhjes, Ministri Malaj theksoi rëndësinë e rritjes së të ardhurave buxhetore, si një element kyç për garantimin e qëndrueshmërisë fiskale dhe financimin e politikave publike. Në këtë kuadër, u nënvizua nevoja për forcimin e kontrolleve, përmirësimin e analizës së riskut dhe përdorimin e instrumenteve

moderne për parandalimin dhe goditjen e shmangies fiskale. Një vëmendje e veçantë iu kushtua luftës kundër informalitetit, si prioritet i qeverisë për krijimin e një mjedisi të drejtë dhe konkurrues për bizneset, si dhe për mbrojtjen e interesit publik.

► LEXO MË SHUMË

